

KRIJOHET BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË

VIZITË NË BANKËN BOTËRORE NË SHBA

UJËSJELLËS I RI PËR DURRËSIN

TIRANË- DURRËS, ZERO TARIFË NË SHTATOR

RRJET I RI UJËSJELLËS NË BELSH

RISHIKOHET TESTI TEORIK KLASI B

Krijohet për herë të parë “Bursa Shqiptare e Energjisë”, e cila shënon një standard të ri të operimit dhe transparencës së këtij sektori dhe do të jetë një nxitje për hapjen dhe derregullimin e tregut të energjisë elektrike. Hapja e bursës garanton funksionim të shpejtë dhe fleksibël të tregut, rrit sigurinë e furnizimit me energji, si dhe përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra kundrejt KEE.

Projekte të rëndësishme në fushën e infrastrukturës janë diskutuar gjatë takimeve që ministrja Belinda Balluku ka zhvilluar në selinë e Bankës Botërore në Uashington. Projekti për rehabilitimin e urave, projekti më i ri për ngritjen e Qendrës së Menaxhimit të Trafikut Rrugor si dhe riorganizimi i ARRSH për ngritjen e kapaciteteve përmes pavarësisë financiare ishin në fokus të diskutimeve me drejtues të lartë të BB.

Qyteti i Durrësit dhe zonat përreth do të ketë një furnizim më të mirë me ujë të pijshëm në saj të ndërtimit dhe vënies në funksion të rrjetit të ri të ujësjellësit të ndërtuar në zonën e Fushë-Kuqes. Linja e re e furnizimit me ujë, një investim i Bankës Botërore në vlerën e 62.5 milionë euro, do të jetë plotësisht në funksion në fund të muajit qershor dhe do të garantojë një furnizim me 18 orë ujë në ditë për qytetarët.

Nuk do të ketë asnjë tarifë për përdoruesit e rrugës Tiranë-Durrës në muajin shtator. Ministrja Balluku bëri të ditur se në shtator do të hapet gara për projektin, duke garantuar një garë transparente, dhe pas shpalljes së kompanisë fituese puna do të nis me rehabilitimin e rrugës Tiranë-Plepa, e cila do shërbejë si rrugë alternativë pa pagesë, dhe më pas do të punohet për zgjerimin dhe përmirësimin e të gjitha parametrave të autostradës Tiranë-Durrës.

33 mijë banorë të Belshit dhe zonave përreth do të kenë një furnizim 24 orë me ujë të pijshëm në saj të rrjetit të ri të ujësjellësit që do të ndërtohet. Punimet janë parashikuar të nisnin brenda dy muajve të ardhshëm. Prej vitit 1983, investimet në këtë sektor në zonën e Dumresë kanë qenë minimale.

Nga 1 qershori do të aplikohet testi i ri teorik për klasin B. Nga 4864 pyetje janë eliminuar 1199 pyetje dhe janë korigjuar 1848 pyetje me gabime gramatikore ose kuptimore. Nga 4864 pyetje në total numri i tyre shkon në 3665, të konsultuara me grupet e interesit dhe ekspertë. Qëllimi i ndërhyrjes ishte për ta bërë testin e ri më të kuptueshëm, më korrekt, më praktik dhe objektiv.